

Procesverbali i takimit të mbajtur më 15 qershor 2016

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i përgjithshëm i gjendjes në Kolegj (vazhdim nga mbledhja e datës 06.01.2016)
2. Raport mbi gjendjen e përgjithshme në Kolegj i Kryetarit të Këshillit z. Andi Belegu
3. Planifikimi i ardhshëm i aktiviteteve të Këshillit të Studentëve (vazhdim nga mbledhja e datës 06.01.2016)

Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Studentëve të Kolegjit.

Në pikën e parë u diskutua gjendja në Kolegj, anëtarët e Këshillit të Studentëve paraqitën raportet interne që identifikuan problemet në aspektin akademik dhe organizimin teknik të Kolegjit. Studentët potencuan nevojën për miratimin e rregulloreve që ndikojnë në integritetin akademik, integritetin në hulumtim dhe politikat për parandalimin e plagjiaturës.

Kryetari i Këshillit të Studentëve Z. Andi Belegu morri fjalën në mbledhje. Ai paraqiti mendimet e tij për vitin akademik dhe potencoj nevojën për më shumë tutorë në përhatitjen e temës së diplomës. Z. Belegu gjithashtu mirëpriti idenë e futjes së vlerësimit të tërë programit nga ana e studentëve dhe futjes së saj në sistemin e notave.

Disa aktivitete u propozuan si aktivitetet akademike, klubet e leximit dhe debateve, ahengjet dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me punën e përditshme të kolegjit. Aktivitetet u aprovuan dhe mbeten të diskutohen brenda organizatës.

Procesverbalin e mbajti Nënkryetari i Këshillit të Studentëve

Albion Sutaj

